Vlera e bodit për rrogat e nëpunësve shtetëror për vitin 2016 do të përcaktohet me vendim të veçantë për përcaktimin e vlerës së pikës për rrogat e nëpunësve shtetëror, që e miraton Këshilli, përderisa për të punësuarit në administratën komunale që nuk kanë statusin e nëpunësit shtetëror përlllogaritja e rrogave do të bëhet sipas kriterit "DPP", duke shumëzuar koeficientin i ndërlkueshmerisë për llojin e caktuar të kualifikimit caktuar me Marrëveshtjen kolektive për organet shtetërore, jurisprudencën dhe vetqeverisjen lokale në Republikën e Maqedonisë me vlerën 4266 denarë dhe do të vlejë për periudhën 1.01.2016-31.12.2016.

**Neni 7**

Të punësuarve në administratën komunale u paguhet kompensim për pushim vjetor në lartësinë 60% të rrogës mesatare neto të paguar në tre muajt e fundit në Republikë.

**Neni 8**

Rroga e personave të zgjedhur dhe emëruar në Komunën e Dibrës përcaktohet në pajtim me dispozitat e Ligjit për rroga dhe kompenzime tjera të deputetëve në Kuvendin e RM-së dhe personave tjerë të zgjedhur dhe emëruar në Republikë, ndërsa vlera e koeficientit për përcaktimin e rrogës të personave të zgjedhur dhe emëruar është 26.755,00 den.

**Neni 9**

Anëtarëve të Këshillit të Komunës u takon kompensim mujor për pjesëmarrje në seancat e Këshillit dhe kompensim të shpenzimeve ditore dhe të rrugës.

Mjetet për pagesë të kompensimeve nga paragrafi 1 i këtij neni sigurohen në Buxhetin e komunës Dibër.

**Neni 10**

Kompensimi mujor për pjesëmarrje në seancat e Këshillit përcaktohet në lartësinë 50% të rrogës mesatare mujore neto në Republikë, paguar në vitin e kaluar.

**Neni 11**

Kryetarit të Këshillit të komunës për udhëheqje dhe organizim të punës së Këshillit kompensimi nga neni 9 i rritet për 30%.

**Neni 12**

Anëtarëve të Këshillit u paguhet kompensim për shpenzimet rrugore dhe ditore gjatë udhëtimeve zyrtare në vend dhe jashtë, në pajtim me dispozitat që kanë të bëjnë me nëpunësit shtetëror në administratën komunale të Komunës Dibër.

**Neni 13**

Pagesa e rrogave dhe kompensimeve të enteve publike që financohen nga buxheti i Komunës me blok dotacione kontrollohet dhe lejohet nga Ministria e Financave.

Komuna është e obliguar dy ditë para pagesës së rrogave të punëtorëve, deri te ministria përkatëse dhe Ministria e Financave të paraqet kërkesë për lejimin e mjeteve për rroga, duke bashkangjitur formularët PDD-MP dhe MP-1, kopje të rekapitularit për llogaritje të rrogave, formularin F-1 për numrin e punëtorëve me emër dhe mbiemër, rrogat dhe kompensimet tjera për muajin përkatës për pagesë të rrogave dhe formularin 6.

**Neni 14**

Të punësuarve në institucionet lokale komunale të cilët detyrat e punës i kryejnë jasht vendbanimit respektivisht në pjesë të venbanimeve në komunën e Dibrës punëdhënësi me shpenzimet e veta mund tu organizojë transport në dhe prej vendit të punës.

**Neni 15**

Në raste të pushimit mjekësor më gjatë se gjashtë muaj dhe në rastet të pasojave të rënda nga fatkeqësitë elementare në kuptim të Ligjit për mbrojtje nga fatkeqësitë elementare si dhe në raste të tjera, punëtorit i paguhet ndihmë në lartësinë e një rroge mestare mujore të fundit paguar në Organin ku është i punësuar.

**Neni 16**

Kompensimi për pensionim të punësuarit paguhet në bazë të nenit 9 paragrafi 2 alineja 2 të Ligjit për pagesë të rrogave, dhe është shuma e dyfishtë e rrogës neto mujore mesatare për punëtor në Republikë e shpallur deri në ditën e pagesës.

**Neni 17**

Në rast vdekje të punëtorit në administratën komunale dhe entin publik lokal, familjes së tij i takon ndihmë në të holla në lartësinë 30.000 den.

Punëtorit në administratën komunale dhe entin publik lokal në rast vdekje të anëtarit të familjes së ngushtë ( prind, bashkëshort fëmij të lindur në martesë ose jashtë saj, fëmij të adaptuar, fëmij të marrë në kujdesje) nëse ka jetuar në bashkësi i takon ndihmë në të holla në lartësinë 15.000 den. për familje.

Jetesa në bashkësi nënkupton, i punësuarit në administratën komunale dhe institucionin lokal publik dhe anëtari i familjes të kenë vëndin e banimit në adresë të njejtë, gjë që dëshmohet me dokument identifikimi, (letër njoftimi ose pasaportë).

Pagesat e këtyre kompensimeve realizohen mbi bazën e dokumentacionit të kompletuar dhe aktvendimit të miratuar nga Kryetari i Komunës.

Për punëtorët të angazhuar me kontrata për punësime të përkohëshme, mjetet për pagesë në ndihmës solidarë të punëtorëve i siguron punëdhënësi, përderisa pagesën e bën Agjensioni për punësime të përkohëshme.

**Neni 18**

Mjetet për mallra dhe shërbime që janë të nevojshme për kryerjen e funksioneve të rregullta të shrytëzuesve të Buxhetit sigurohen me fatura në të cilat në veçanti tregohen shpenzimet në pozicione të veçanta.

Furnizimi me mallëra dhe kryerja e shërbimeve mund të bëhet edhe me vërtetimpagese, por vetëm në vlera të kufizuara pagese në 6.000 denarë, të cilës obligativisht i bashkangjitet llogaria fiskale me ç'rast shpenzimet duhet të tregohen sipas klasifikimit të të dalave përkatëse.

**Neni 19**

Për financimin e shpenzimeve të pa parashikuara ose shpenzimeve më pak të planifikuara, parashifet rezerva buxhetore në vlerë 3% të Buxhetit ( të të hyrave burimore ).

Për mjetet të përcaktuara në Buxhetin e Komunës në kuadër të rezervës ( rezervës buxhetore të përhershme dhe vijuese) vendos Këshilli i komunës, përderisa për vlerat deri më 50.000 denarë mundet të vendos Kryetari i Komunës, dhe të njejtat i realizon Kryetari i Komunës. Për mjetet e shfrytëzuara Kryetari i Komunës është i obliguar të jep raport për shfrytëzimin e mjeteve nga rezerva.

**Neni 20**

Mjetet e përcaktuara me Buxhet dhe të shpërndara nëpër programe e realizon Kryetari i Komunës Dibër.

**Neni 21**

Ky vendim hyn në fuqi me ditën e shpalljes në “Kumtesën zyrtare të Komunës Dibër” dhe do të aplikohet nga 1 janari 2016.

**KËSHILLI I KOMUNËS**  
**Kryetari,**  
**Bashkim Mashkulli d.v.**



**K O N K L U Z I O N**  
**Nr.08-1249/3 dt. 29.12.2015**  
**PËR SHPALLJEN E VENDIMIT PËR CAKTIMIN E VLERËS SË PIKËS**  
**PËR PËRLLOGARITJEN E RROGËS SË NËPUNËSVE SHTETËROR**  
**PËR VITIN 2016 NË KOMUNËN DIBËR**

**475.**Në mbështetje të nenit 50 të Ligjit për vetadministrimin lokal (“Gazeta zyrtare e RM” nr.5/02) si dhe nenit 45 të Statutit të Komunës Dibër (“Kumtesa zyrtare e Komunës”nr.14/03),

Kryetari i Komunës Dibër:

**K o n k l u d o i**

Shpallet vendimi për caktimin e vlerës së pikës për përllogaritjen e rrogës së nëpunësve shtetëror për vitin 2016 në Komunën Dibër, miratuar nga Këshilli i Komunës në seancën e 30<sup>të</sup> dt. 25.12.2015.

**KOMUNA DIBËR**  
**Kryetari,**  
**Ruzhdi Lata d.v.**

**V E N D I M**

**Nr.07-1219/6 dt. 25.12.2015**

**PËR CAKTIMIN E VLERËS SË PIKËS PËR PËRLLOGARITJEN E  
RROGËS SË NËPUNËSVE SHTETËROR PËR VITIN 2016  
NË KOMUNËN DIBËR**

**476.**Në mbështetje të nenit 88 paragrafi 2 të Ligjit për nëpunës administrativ ("Gazeta zyrtare e RM" nr. 27/14,199/14, 48/15 dhe 154/15) dhe nenit 59 të Statutit të Komunës Dibër ("Kumtesa zyrtare e Komunës" nr 14/03), Këshilli i Komunës Dibër në seancën e 30<sup>të</sup> dt. 25.12.2015 vendosi:

**Neni 1**

Vlera e pikës për përlllogaritjen e rrogave të nëpunësve shtetëror për vitin 2016 në Komunën Dibër është 76.8 denarë.

**Neni 2**

Ky vendim hyn në fuqi me ditën e shpalljes në Kumtesën zyrtare të Komunës, ndërsa do të aplikohet me pagesën e rrogës për muajin Janar 2016.

**A r s y e t i m**

Në mbështetje të nenit 88 paragrafi 2 të Ligjit për nëpunës administrativ, Këshilli i komunës me vendim të veçantë përcakton vlerën e pikës për përlllogaritjen e rrogave të nëpunësve shtetëror, me propozim të kryetarit të komunës, në kuadër të buxhetit të paraparë dhe në bazë të numrit të përgjithshëm të nëpunësve administrativë të sistemuar sipas niveleve përkatëse për vitin rrjedhës.

Vlera e pikës për përlllogaritjen e rrogave të nëpunësve shtetërorë për vitin 2016 në Komunën Dibër do të jetë 76,8 denarë.

Duke marrë parasysh këtë miratohet dhe vendim për caktimin e vlerës së pikës. Vendimi hyn në fuqi me ditën e shpalljes në Kumtesën zyrtare të Komunës, ndërsa do të aplikohet me pagesën e rrogës për muajin Janar 2016.

**KËSHILLI I KOMUNËS**  
**Kryetari,**  
**Bashkim Mashkulli d.v.**

**K O N K L U Z I O N**  
**Nr.08-1249/4 dt. 29.12.2015**  
**PËR SHPALLJEN E PËRFUNDIMIT PËR SJELLJEN E PROGRAMIT**  
**PËR MIRËMBAJTJEN E PASTËRTINË PUBLIKE**  
**NË TERRITORIN E KOMUNËS DIBËR PËR VITIN 2016**

**477.**Në mbështetje të nenit 50 të Ligjit për vetadministrimin lokal (“Gazeta zyrtare e RM” nr.5/02) si dhe nenit 45 të Statutit të Komunës Dibër (“Kumtesa zyrtare e Komunës”nr.14/03),

Kryetari i Komunës Dibër:

**K o n k l u d o i**

Shpallet përfundimi për sjelljen e Programit për mirëmbajtjen e pastërtisë publike në territorin e Komunës Dibër për vitin 2016 nga Këshilli i Komunës në seancën e 30<sup>të</sup> dt. 25.12.2015.

**KOMUNA DIBËR**  
**Kryetari,**  
**Ruzhdi Lata d.v.**

**P Ë R F U N D I M**  
**Nr. 07-1219/7 dt. 25.12.2015**  
**PËR SJELLJEN E PROGRAMIT PËR**  
**MIRËMBAJTJEN E PASTËRTINË PUBLIKE**  
**NË TERRITORIN E KOMUNËS DIBËR PËR VITIN 2016**

**478.**Në mbështetje të nenit 59 të Statutit të Komunës Dibër (“Kumtesa zyrtare e Komunës”nr.14/03),

Këshilli i Komunës Dibër në seancën e 30<sup>të</sup> dt. 25.12.2015 përfundoi:

1. Këshilli i Komunës Dibër solli Programin për mirëmbajtjen e pastërtisë publike në territorin e Komunës Dibër për vitin 2016.
2. Pjesë përbërëse e përfundimit është Programi nga pika 1.
3. Ky përfundim hyn në fuqi ditën e miratimit dhe do të shpallet në “Kumtesën zyrtare të Komunës”

**KËSHILLI I KOMUNËS**  
**Kryetari**  
**Bashkim Mashkulli d.v.**

## **Nr.30/29.12.2015 KUMTESA ZYRTARE E KOMUNËS faq. 904**

**479.**Në mbështetje të nenit 12 paragrafi 1 të Ligjit për pastim publik (“Gazeta zyrtare e RM” nr 111/2008, 64/2009, 88/2010, 23/2011, 53/2011, 80/2012, 163/13, 44/2015 dhe 147/2015), nenit 41 të Ligjit për administrim me mbeturinat (“Gazeta zyrtare e RM” nr 68/2004, 71/2004, 107/2007, 102/2008, 143/2008, 124/2010, 51/11, 123/12, 147/13, 163/13,51/15,146/15 dhe 192/2015) dhe nenit 45 paragrafi 1 të Statutit të Komunës Dibër (“Kumtesa zyrtare e Komunës” nr 14/03), në përputhje me nenin 5 të Vendimit për mbajtje të pastërtisë publike në territorin e Komunës Dibër nr.07-218/4 data 09.03.2010 (“Kumtesa zyrtare e Komunës” nr 11/10).

Këshilli i Komunës Dibër në seancën e 30<sup>te</sup> dt. 25.12.2015, solli:

### **PROGRAMIN PËR MIRËMBAJTJEN E PASTËRTISË PUBLIKE NË TERRITORIN E KOMUNËS DIBËR PËR VITIN 2016**

#### **I.QËLLIMI STRATEGJIK**

Programi i Komunës Dibër për mirëmbajtjen e pastërtisë publike është i orientuar kah mirëmbajtja e pastërtisë publike e sipërfaqeve publike dhe hapsirave të hapura të objekteve publike, me qëllim të sigurimit të kushteve më cilësore për jetën e qytetarëve dhe për ambient më të pastër jetësor në komunë.

#### **II.QËLLIMET E PROGRAMIT**

Qëllimi i përgjithshëm i Programit është që të sigurohet pastrim i rregullt (fshirje dhe larje) i sipërfaqeve publike dhe hapsirave të hapura në objektet publike, si dhe pastrimi i borës dhe akullit (prej trotuareve dhe hapsirave të hapura në objektet publike) në kushte dimërore.

Me këtë program:

-Përcaktohet territori dhe orari për mirëmbajtje (pastrim dhe larje) të sipërfaqeve publike dhe hapësirave të hapura të objekteve publike;

-Përcaktohen mënyrat themelore për kryerjen e punëve për mirëmbajtje të pastërtisë publike;

-Përcaktohet mbikëqyrja e zbatimit;

-Përcaktohet mënyra e financimit.

#### **III. LËNDA E PROGRAMIT**

Mirëmbajtja e pastërtisë publike në territorin e Komunës Dibër do të përfshijë:

- Sipërfaqet publike (rrugët, trotuarët, rrugët hyrëse, sheshet dhe hapësirat e hapura të rregulluara, parkingjet, vendndalesat e autobuseve dhe stacionet e taksive, nyjeve sanitare publike).

Mirëmbajtja e pastërtisë publike nëpër hapësirat e parqeve dhe gjelbërimeve në qytet nuk është pjesë e këtij programi, por pjesë e programit për mirëmbajtjen dhe rregullimin e gjelbërimit të qytetit, me përjashtim të marrjes dhe transportimit të mbeturinave;

Në zbatimin e programit kryen këto aktivitete:

-Pastrimi me dorë i sipërfaqeve publike,

-Pastrimi me makinë i rrugëve nga dheu i krijuar nga rreshjet e shiut,

-Larja e sipërfaqeve publike me cisternë,

-Mbledhja dhe transportimi i mbeturinave nga mirëmbajtja e pastërtisë publike dhe transportimi e tyre në deponinë komunale,

-Pastimi i borës dhe akullit (nga trotuarët dhe hapësirave publike të objekteve) në kushte dimërore.

Në pajtim me programin do të bëhet fshirja e: rrugëve, parkingjeve shesheve, rrugëve hyrëse në qytet, nyjeve sanitare publike dhe hapësirave të hapura të rregulluara, vendalimet e autobuseve dhe stacionet e taksive, larja e rrugëve dhe parkingjeve, pastrimi me dorë i borës dhe akullit në kushtet dimërore me sipërfaqe të përgjithshme efektive të mirëmbajtjes prej 59.900,00 m<sup>2</sup>.

**IV.REALIZUESI I PROGRAMIT**

Programin për mirëmbajtje të pastërtisë publike do ta realizojë NKP “Standard”.

**V.AKTIVITETET**

Gjatë përcaktimit të sipërfaqeve publike që do të mirëmbahen me këtë program janë marrë parasysh: dendësia e popullatës, lëvizja e qytetarëve dhe komunikacionit, objektet sociale,kulturore dhe edukative-arsimore.

**VI.DINAMIKA E REALIZIMIT TË PROGRAMIT**

**VI.1. FSHIRJA E SIPËRFAQEVE PUBLIKE**

**1. FSHIRJA E RRUGËVE**

**A.Pastrimi i rrugëve çdo ditë përveç të dielave (kategoria e parë)**

Prej në ora 7.00 deri më ora 14.00 në periudhën e dimrit

Prej në ora 5.00 deri në ora 12.00 në periudhën e verës

Realizuesi është i obliguar të shpazë edhe korpat për mbeturina të hapësirave publike.

Nr. rën.	Rruga	Përshkrimi	Hapësira efektive m <sup>2</sup>
1	Rr. “Vëllazërim Bashkim“	Prej te udhëkryqi me rr. “8 Shtatori” deri te bashkimi me rr. “22 Dhjetori”	3000
2	Rr. “8-të Shtatori”	Prej te Ura në hyrje deri te udhëkryqi me rr “Vëllazërim Bashkim “	6000
3	Pjesë e rr. “APJ”	Prej te udhëkryqi me rr “Vëllazërim Bashkim” deri te hyrja e Hamamit të qytetit	200
4	Degë e rr. “8-të Shtatori”	Prej te udhëkryqi me rr “8 Shtatori” deri te bashkimi me rr “Velko Vllahoviq”	600
			9.800 m <sup>2</sup>

**B.Fshirja e rrugëve një herë në javë (kategoria e dytë)**

Prej në ora 7.00 deri në ora 14.00 në periudhën e dimrit

Prej në orën 5.00 deri në ora 12.00 në periudhën e verës

Realizuesi është i obliguar të shpazë edhe korpat për mbeturina të sipërfaqeve publike.

Nr rr.	Rruga	Përshkrimi	Hapësira efektive m <sup>2</sup>
1	Rr “Velko Vllahoviq”	Prej te udhëkryqi me rr “Bashkim Vëllazërim” deri te unaza	2100
2	Rr “Atanas Iliç”	Prej te udhëkryqi në rr “Velko Vllahoviq” deri te Shtëpia e zjarrfiksave	2100
3	Rr. “Jordan Zafirovski”	Prej te bashkimi me rr.” Vëllazërim Bashkim” deri te bashkimi me rr. “Amdi Lleshi”	1000
4	Degë e rr. “Bashkim Vëllazërim”	Rreth kompleksit “Pazari i qytetit” deri te udhëkryqi me rr “Amdi Lleshi”	800
			6.000 m <sup>2</sup>

**Nr.30/29.12.2015 KUMTESA ZYRTARE E KOMUNËS faq. 906****V. Fshirja e rrugëve nji herë në muaj (kategoria e tretë)**

Prej në ora 7.00 deri në ora 14.00 në periudhën e dimrit

Prej në orën 5.00 deri në ora 12.00 në periudhën e verës

Realizuesi është i obliguar të shprazë edhe korpat për mbeturina të sipërfaqëve publike.

Nr. rr	Rruga	Përshkrimi	Hapësira efektive m <sup>2</sup>
1	Rr "1 Maji"	Prej te udhëkryqi me unazë deri te rr. "APJ"	2500
2	Rr "APJ"	Prej te rr "1 Maji" deri te hyrja e Hamamit të qytetit	300
3	Rr "Ibe Palikuqa"	Prej te rr "APJ" deri tek lidhja me rr "Bashkim Vëllazërim"	1000
4	Bulevari "Iliria"(100)	Me gjithë gjatësinë	3000
5	Bulevar "Shkupi"	Me gjithë gjatësinë	2500
6	Rr "Urfi Agolli"	Me gjithë gjatësinë	900
7	Rr "Mosha Pijade"	Me gjithë gjatësinë	800
			11.000m <sup>2</sup>

**D. Fshirja e rrugëve në dy muaj (kategoria e katërt)**

Prej në ora 7.00 deri në 14.00 në periudhën e dimrit

Prej në orën 5.00 deri në 12.00 në periudhën e verës

Realizuesi është i obliguar të shprazë edhe korpat për mbeturina të sipërfaqeve publike.

Nr. Rën.	Rruga	Përshkrimi	Hapësira efektive m <sup>2</sup>
1	Rr"Zdravko Çoçkovski"	Prej te rr." Bashkim Vëllazërim" deri te rr."Dilaver Sela"	600
2	Rr"Amdi Lleshi"	për gjithë gjatësinë	1800
3	Rr "Beton"	për gjithë gjatësinë	1800
4	Rr "Brigada e 7-të shqiptare"	për gjithë gjatësinë	1800
5	Rr"Edvard Kardel"	Prej te rr. "Amdi Lleshi" deri te SHF"Said Najdeni"	1500
6	Rr"22 Dhjetori"	Prej te rr."Amdi Lleshi" deri te varrezat e qytetit	2600
7	Rr"Xhavit Ushtelena"	Prej te rr."Amdi lleshi" deri te "Korpusi 15"	3000
8	Rr "Leninova"	për gjithë gjatësinë	1500
9	Rr "111"	Prej te rr. "Urfi Agolli" deri te rr"204"	1500
10	Rr "204"	Prej te rr "Velko Vllahoviq" deri në fund	900
11	Rr"Velko Vllahoviq"	Prej te unaza deri te Stadiumi i qytetit	4000
12	Rr "Eqerem Zengo"	për gjithë gjatësinë	1900
13	Rr "Korpusi 15"	Për gjithë gjatësinë	2500
14	Rr"Ali Zengovski"	për gjithë gjatësinë	2300
			27.700 m <sup>2</sup>

**2. FSHIRJA E PARKINGJEVE**

**Fshirja e parkingjeve bëhet dy herë në javë**

Nr.rr.	Parkingu	Hapësira efektive m <sup>2</sup>
1	Te parku i qytetit	1200
2	Te Banka Ekonomike	1200
3	Te qendra medicinale	1500
4	Para komunës Dibër	1500
		5.400 m <sup>2</sup>

**3. MIRËMBAJTJA E NYJEVE SANITARE PUBLIKE**

**1.Nyja sanitare në kuadër të parkut të qytetit**

Mirëmbajtja është e rregullt në pajtim me rregullat higjienike-sanitare. Financimi nuk është pjesë e këtij programi.

**4.FSHIRJA E NDALESAVE TË AUTOBUSËVE DHE STACIONEVE TË TAKSIVE**

Financimi nuk është pjesë e këtij programi. Fshirja e ndalesave të autobusave dhe stacioneve është në suazat e mirëmbajtjes së rrugëve. Prandaj këtu nuk është paraqitur sipërfaqja efektive për pastrim.

Financimi është përfshirë në pjesën për pastrimin e rrugëve.

**VI.2.LARJA E SIPËRFAQEVE PUBLIKE**

Larja e rrugëve bëhet prej në ora 22.00 deri në ora 6.00 në periudhën e verës nga 1 Maji deri më 30 tetor

**A.Larja e rrugëve çdo ditë (katër herë në muaj për rrugë)**

Nr.rr.	Rruga	Përshkrimi	Hapësira efektive m <sup>2</sup>
1	Rr. “Bashkim Vëllazërim”	Prej te udhëkryqi me rr “8 Shtatori” deri te bashkimi me rr “22 Dhjetori”	5.200
2	Rr“8 Shtatori”	Prej te Ura në hyrje deri te udhëkryqi me rr. “Vëllazërim Bashkim”	16.600
3	Rr“Velko Vllahoviq”	Prej te udhëkryqi me rr “Vëllazërim Bashkim”deri te udhëkryqi me Unazën	7.000
4	Rr“Atanas Iliq”	Prej te udhëkryqi me rr “Velko Vllahoviq” deri te Shtëpia e zjarrfiksave	5.500
5	Pjesë e rrugës “APJ”	Prej te udhëkryqi me rr. “Vëllazërim Bashkim” deri te hyrja e Hamamit të qytetit	300
6	Bulevardi “Iliria” (100)	për gjithë gjatësinë	8.000
			42.600 m <sup>2</sup>

**VI.3.PASTRIMI ME DORË I BORËS DHE AKULLIT NË KUSHTET E DIMRIT**

Në periudhën dimërore nëse bie borë, në vend të zërit për fshirje dhe larje nga ky program, realizuesi duhet të pastrojë borën dhe akullin nga trotuaret të përshkruara në tabelën e mëposhtme.

Pastrohen trotuaret dhe hapësirat lidhëse në pjesët ku nuk ka objekte të personave fizikë dhe juridikë.



Nr. rën.	Rruga	Përshkrimi	Hapësira efektive m <sup>2</sup>
1	Rr “Shtatori”	Prej te Ura deri te udhëkryqi me unazë	2.400
2	Rr“Velko Vllahiviq”	Prej te udhëkryqi me rr. “Vëllazërim Bashkim” deri te unaza	2.400
3	Rr “Atanas Iliq”	Prej në rr “Velko Vllahoviq” deri te Shtëpia e zjarrfiksave	2.400
4	Dega e rr “8 Shtatori”	Trotuare dhe rrugica rreth parkut të qytetit	600
5	Bulevardi “Iliria” (100)	për gjithë gjatësinë	2.000
6	Rr“Velko Vllahoviq”	Prej tek unaza deri tek Stadiumi i qytetit	2.500
7	Bulevardi “Shkupi”	Prej te rr.“Velko Vllahoviq” deri tek stacioni i autobusëve	1.200
8	Rr “22 dhjetori”	Prej tek rr.“Amdi Lleshi” deri te hyrja e qytetit	2.000
			15.500m <sup>2</sup>

#### **VI.4.Parallogaria e sipërfaqeve dhe ditët e punës**

##### **4.1. Fshirja**

N.r	Kategoria	Hapësira	Ditët e punës për fshirje
1	Kategoria e parë	9.800	288
2	Kategoria e dytë	6.000	96
3	Kategoria e tretë	11.000	24
4	Kategoria e katërt	27.700	12
5	Parkingjet	5.400	96
			516

##### **4.2. Larja**

N.r.	Kategoria	Hapësira	Ditët e punës për larje
1	Kategoria e parë	42.600	28
			28

##### **4.3. Pastrimi i borës nga trotuaret**

N.r	Kategoria	Hapësira	Ditët e punës për pastrim
1	Kategoria e parë	15.500	Varësisht nga bora

#### **VI.5. MIRËMBAJTJA JASHTA PROGRAMIT, BUXHETI DHE FINANCIMI**

NKP “Standard” është e obliguar të veprojë edhe sipas vendimeve të sjella nga inspektori për punë komunale dhe inspektori i autorizuar për ambient jetësor për pastrimin e deponive të vogla dhe sipërfaqeve publike, të cilat janë jashtë programit dhe janë të ndotura jo rregullisht dhe ku konstatohet që ka mbeturina me prejardhje të panjohur.

NKP “Standard” do të pastrojë hapësirën menjëherë pas mbajtjes së manifestimeve të cilat i organizon Komuna Dibër.

##### **5.1. Llogaria e shpenzimeve për mirëmbajtjen e pastërtisë publike**

-vlera e punës së dorës për orë

Fshirës..... 90,00 den./orë

Larës..... 90,00 den./orë

-vlerësimi i mjeteve themelore për orë

Cisterna..... 1.780,00 den./orë

Traktori..... 750,00 den./orë

Ngarkuesi..... 2.200,00 den./orë

Makina e mbeturinave..... 1.580,00 den./orë

-Llogaria e vlerësimit të punës së dorës për m<sup>2</sup>

- 1.Fshirje çdo ditë ..... 0.0010783 x 90.00=0,10 den./m<sup>2</sup>
- 2.Fshirje dy herë në javë ... 0.0012313 x 90,00=0,11 den./m<sup>2</sup>
- 3.Fshirje dy herë në muaj.... 0,0036388 x 90,00=0,437 den./m<sup>2</sup>
- 4.Fshirje një herë në muaj.. 0,0036388 x 90,00=0,437 den./m<sup>2</sup>
- 5.Larja me zorë me dy larës 0,00123 x 1.960,00=2,410 den./m<sup>2</sup>

**VI.6. Pasqyra e plotë e punëve në nivel vjetor dhe llogaria e shpenzimeve për fshirje për v.2016**

Lloji i shërbimit	Kategoria	Hapësira	Ditët e intervenimit	Hapësira e plotë vjetore	Çmimi den/m <sup>2</sup>	Gjithsejt den.
Fshirje	Kategoria e parë	9.800,00	288	2.822.400	0,10	282.240,00
Fshirje	Kategoria e dytë	6.000,00	96	576.000	0,11	63.360,00
Fshirje	Kategoria e tretë	11.000,00	24	264.000	0,437	115.368,00
Fshirje	Kategoria e katërtë	27.700,00	12	332.400	0,437	53.489,00
Fshirje	parkingjet	5.400,00	96	518.400	0,11	57.024,00
		59.900,00				571.481,00

**VI.7. Pasqyrë e plotë për punët në nivel vjetor dhe llogaria e shpenzimeve për larjen për vitin 2016.**

Lloji i shërbimit	Kategoria	Sipërfaqe	Ditët e intervenimit	Sipërfaqe e plotë vj.	Çmim den/m <sup>2</sup>	Gjithsejt den.
Larja e rrugëve dhe trotuarëve	Kategoria e parë	42.600,00	28	1.192.800	2,41	2.892.540,00

Në këtë program është paraparë mirëmbajtja e plotë vjetore e sipërfaqeve publike, edhe atë:

-fshirje 4.513.200 m<sup>2</sup>, larje 1.192.800 m<sup>2</sup>, pastrim i borës dhe akullit në kushtet dimërore 15.500 m<sup>2</sup>.

Për mirëmbajtjen e kësaj sipërfaqeje me vëllim dhe frekuentim të paraparë sipas programit janë të nevojshme 3.464.021,00 denarë.

Nga kjo del se mirëmbajtja e sipërfaqeve publike në m<sup>2</sup> bën 0,60 denarë/m<sup>2</sup>. Dispozitat e këtij programi nuk kanë të bëjnë me pastrimin publik në rrethana të jashtëzakonshme dhe në kushte të fatkeqësive elementare.

**VI.8. Kompensimi për mirëmbajtjen e pastërtisë publike**

Kompensim për mirëmbajtjen e pastërtisë publike paguajnë të gjithë personat fizik dhe juridikë shfrytëzues të shërbimeve nga ujësjellësi dhe mbledhja e mbeturinave në qytetin e Dibrës.

Vlera e komensimit për mirëmbajtjen e pastrimit publik është:

- për persona fizikë 70.00 denarë në muaj
- për persona juridikë kategoria e parë 250,00 denarë në muaj
- për persona juridikë që kryejnë veprimtari tregtare apo zejtare (shitore të vogla) 150.00 den në muaj
- për persona juridikë që kryejnë veprimtari tregtare apo zejtare (shitore të mëdha dhe prodhimtaria) 300.00 den në muaj

## **Nr.30/29.12.2015 KUMTESA ZYRTARE E KOMUNËS faq. 910**

-për veprimtari avokature dhe notere, këmbimore, agjensione turistike, lojra, zyra për llogari dhe ngjashëm 150.00 den në muaj.

Tatimi në vlerën e shtuar (TVSH) nuk është llogaritur në lartësinë e kompensimit të përcaktuar dha e njehta është në ngarkesë të shfrytëzuesve të shërbimeve.

Aktivitetet e përcaktuara me këtë program do të financohen nga kompensimi për pastrim publik, e cila pagohet përmes faturës për mbledhjen dhe transportimin e mbeturinave komunale, që paraqitet si pozicion i veçantë .

Mjetet e mbledhura nga kompensimi për mirëmbajtje të pastërtisë publike janë të hyra të komunës dhe përdoren për financimin e punëve për pastrimin publik.

Për financimin e këtij programi, komuna Dibër do të nënshkruajë kontratë me NKP “Standard” e cila do të sjellë fatura mujore.

### **VII.MBIKËQYRJA PËR ZBATIMIN E PROGRAMIT**

Mbikëqyrjen e zbatimit të këtij Programi dhe dispozitave të sjella me këtë program e bën Sektori për urbanizëm, mjedis jetësor dhe veprimtari komunale.

Mbikëqyrjen e inspektimit për zbatimin e këtij Programi e bën inspektori për punë komunale dhe kujdestarët komunal.

Për aktivitetet e zhvilluara në teren zbatuesi do të jetë i obliguar tek Komuna Dibër të sjellë raporte mujore për punën e kryer dhe në fund të vitit edhe raport vjetor, i cili do të dorëzohet tek Kryetari i Komunës dhe Këshilli i Komunës Dibër.

**Nr.07-1219/8**  
**25.12.2015**  
**D i b ë r**

**KËSHILLI I KOMUNËS**  
**Kryetari,**  
**Bashkim Mashkulli d.v.**

**K O N K L U Z I O N**  
**Nr.08-1249/5 dt. 29.12.2015**  
**PËR SHPALLJEN E PËRFUNDIMIT PËR SJELLJEN E PROGRAMIT**  
**PËR PUNËN E KËSHILLIT TË KOMUNËS DIBËR PËR v.2016**

**480.**Në mbështetje të nenit 50 të Ligjit për vetadministrimin lokal (“Gazeta zyrtare e RM” nr.5/02) si dhe nenit 45 të Statutit të Komunës Dibër (“Kumtesa zyrtare e Komunës”nr.14/03),

Kryetari i Komunës Dibër:

**K o n k l u d o i**

Shpallet përfundimi për sjelljen e Programit për punën e Këshillit të Komunës për vitin 2016 nga Këshilli i Komunës në seancën e 30<sup>të</sup> dt. 25.12.2015.

**KOMUNA DIBËR**  
**Kryetari,**  
**Ruzhdi Lata d.v.**

**P Ë R F U N D I M**

**Nr. 07-1219/9 dt. 25.12.2015**

**PËR SJELLJEN E PROGRAMIT PËR PUNËN E  
KËSHILLIT TË KOMUNËS DIBËR PËR v.2016**

**481.**Në mbështetje të nenit 36 paragrafi 1 pika 15 të Ligjit për vetëqeverisjen lokale („Gazeta Zyrtare e RM,, nr.5/02) si dhe nenit 59 të Statutit të komunës („Kumtesa Zyrtare e Komunës,, nr 14/03),

Këshilli i Komunës Dibër në seancën e 30<sup>të</sup> datë 25.12.2015 përfundoi:

1.Këshilli i Komunës miraton Programin për punën e Këshillit të komunës Dibër për vitin 2016.

2.Obligohen propozuesit, përpiluesit dhe të gjithë pjesëmarrësit të përcaktuar me Program që të realizojnë obligimet e tyre nga programi dhe me kohë t’i dërgojnë Këshillit të Komunës.

3.Pjesë përbërëse e pëfundimit është Programi nga pika 1.

4.Ky përfundim hyn në fuqi një ditë pas shpalljen në “Kumtesën zyrtare të Komunës”

**KËSHILLI I KOM UNËS**  
**Kryetari,**  
**Bashkim Mashkulli d.v.**

**P R O G R A M**  
**PËR PUNËN E KËSHILLIT TË**  
**KOMUNËS DIBËR PËR VITIN 2016**

**482.**Në mbështetje të nenit 36 paragrafi 1 pika 15 të Ligjit për vetëqeverisjen lokale („Gazeta zyrtare e RM., nr.5/02), nenit 27 paragrafi 1 pika 3 të Statutit të Komunës së Dibrës ("Kumtesa zyrtare e Komunës"nr.14/03) si dhe nenit 92-93 të Rregullores për punë të Këshillit ("Kumtesa zyrtare e Komunës"nr.4/2005),

Këshilli i komunës Dibër në seancën e 30<sup>të</sup> dt. 25.12.2015 solli program për punën e Këshillit për vitin 2016.

**I.Dispozita të përgjithshme**

Në pajtim me kompetencat nga neni 27 i Statutit të komunës së Dibrës Këshilli i Komunës së Dibrës, me propozim të Komisionit për hartimin e programit, miraton Program për punën e vet. Me Programin përfshihen të gjitha aktivitetet e Këshillit për vitin rrjedhës.

Me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë, Ligjin për vetadministrim lokal dhe Statutin e Komunës, në mënyrë normative rregullohet puna dhe njëherit edhe realizimi i pushtetit lokal. Ato janë aktivitete me rëndësi lokale, vecanërisht nga fusha e veprimtarisë komunale, urbanistikës, kulturës, sportit, mbrojtjes primare shëndetësore, edukimit parashkollor, arsimit fillor dhe të mesëm, mbrojtjes së shtazëve dhe bimëve, avancimin e mjedisit jetësor, mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtje nga fatkeqësitë elementare si dhe fusha të tjera të cilat janë në kompetencë të pushtetit vendor.

Këshilli i komunës së Dibrës mund të ndërmerr edhe kompetenca të caktuara të cilat me ligj mund t'i përcillen nga kompetencat e administratës shtetërore.

**II. Përmbajtja e programit.**

Temat e programuara sipas të cilave do të referohet ky organ brënda vitit 2016 janë të parapara dhe përfshira sipas kësaj dinamike.

Janar - Qershor

✓ **Llogaria vjetore e buxhetit për v. 2015**

PËRGATIT: Administrata komunale në bashkëpunim me komisionin përkatës

PROPOZON: Kryetari i Komunës

MIRATON: Këshilli i Komunës

✓ **Vendim për miratimin e llogarisë vjetore të Buxhetit të komunës së Dibrës për vitin 2015.**

PËRGATIT: administrate komunale

MIRATON: Këshilli i Komunës

- ✓ **Strategji për zhvillim ekonomik lokal**  
PËRGATIT: administrate komunale  
MIRATON: Këshilli i Komunës
  
- ✓ **Raport për realizimin e Programit për rregullimin e tokës ndërtimore për v. 2015 dhe Program për vitin 2016**  
PËRGATIT: administrata komunale  
PROPOZON: Kryetari i Komunës  
MIRATON: Këshilli i Komunës
  
- ✓ **Informatë mbi gjendjen në fushën e planifikimit urbanistik në Komunën**  
PËRGATIT: administrata komunale  
MIRATON: Këshilli i Komunës
  
- ✓ **Program për përpilimin e Planeve urbanistike për vitin 2016**  
PËRGATIT: administrata komunale dhe komisioni përkatës.  
MIRATON: Këshilli i Komunës
  
- ✓ **Program për mbrojtje dhe ruajtje të mjedisit dhe natyrës**  
PROPOZON: Administrata komunale  
MIRATON: Këshilli i Komunës
  
- ✓ **Raport për kuartalin e parë për realizimin e Buxhetit të Komunës për vitin 2016**  
PËRGATIT: Administrata komunale
  
- ✓ **Raport vjetor për punën e Këshillit të Komunës Dibër për vitin 2015**  
PËRGATIT: Administrata komunale  
MIRATON: Këshilli i Komunës
  
- ✓ **Raport për punën e Njesisë për inspektim për vitin 2015**  
PËRGATIT: Administrata komunale  
MIRATON: Këshilli i Komunës  
MIRATON: Këshilli i Komunës
  
- ✓ **Raport për realizimin e Programit për ndriçim publik për v. 2015 dhe Program për vitin 2016**  
PROPOZON: Komisioni për ndriçim publik  
MIRATON: Këshilli i Komunës
  
- ✓ **Raport për realizimin e programit për ndërtim, rindërtim, mirëmbajtje dhe mbrojtje të rrugëve lokale dhe rrugicave për vitin 2015 dhe Program për vitin 2016**  
PËRGATIT: Administrata komunale  
MIRATON: Këshilli i Komunës

- ✓ **Raport për punën e Njesisë së zjarrfikësve për vitin 2015 dhe Plani për vitin 2016**  
PËRGATIT: administrate komunale  
MIRATON: Këshilli i Komunës
- ✓ **Program për propagandë turistike për vitin 2016**  
PËRGATIT: Administrata komunale  
MIRATON: Këshilli i Komunës.
- ✓ **Raport për lidhjen e martesave në Komunën e Dibrës për vitin 2016**  
PROPOZON: trupi përkatës  
MIRATON: Këshilli i Komunës
- ✓ **Raport për punën e NKP"Standard" Dibër për vitin 2015**  
PËRGATIT: NKP"Standard" Dibër  
MIRATON: Këshilli i Komunës
- ✓ **Plan për punën e NKP"Standard" Dibër për vitin 2016**  
PËRGATIT: NKP"Standard" Dibër  
MIRATON: Këshilli i Komunës
- ✓ **Raport për mirëmbajtjen e higjienës komunale të sipërfaqeve publike për vitin 2015**  
PËRGATIT: NKP"Standard" Dibër  
MIRATON: Këshilli i Komunës
- ✓ **Program për mirëmbajtjen e higjienës komunale të sipërfaqeve publike në Komunën e Dibrës për vitin 2016**  
PËRGATIT: NKP"Standard" Dibër  
MIRATON: Këshilli i Komunës
- ✓ **Raport për kuartalin e dytë për realizimin e Buxhetit të Komunës për vitin 2016**  
PËRGATIT: Administrata komunale  
MIRATON: Këshilli i Komunës
- ✓ **Pyetje këshilltarësh**



**Korrik-dhjetor**

- ✓ **Informatë për punën me organizatat joqeveritare fondeve dhe realizimi i projekteve ndërkombëtare**  
PROPOZON: Kryetari i Komunës  
MIRATON: Këshilli i Komunës
  
- ✓ **Informatë për punën e Bashkësive lokale në Komunë**  
PËRGATIT: Këshilli komunal i Bashkësive lokale  
MIRATON: Këshilli i Komunës
  
- ✓ **Raport për punën e shkollave fillore në Komunën Dibër për vitin 2015/2016 dhe programet vjetore për vitin 2016/2017**  
PËRGATIT: Shkollat fillore  
MIRATON: Këshilli i Komunës
  
- ✓ **Raport për punën e Shkollën e Mesme Komunale për vitin 2015/2016 dhe programi vjetor për vitin 2016/2017**  
PËRGATIT: SHMK  
MIRATON: Këshilli i Komunës
  
- ✓ **Raport për punën e EPKF "Breshia "Dibër për vitin 2015/2016 dhe Programi vjetor për vitin 2016/2017**  
PËRGATIT: EPKF "Breshia "Dibër  
MIRATON: Këshilli i Komunës
  
- ✓ **Informatë për punën e Qendrën për punë sociale Dibër për vitin 2015 dhe Programi për vitin 2016**  
PËRGATIT: Qendra  
MIRATON: Këshilli i Komunës
  
- ✓ **Informatë për punën e NJR të Bujqësisë Dibër për vitin 2015**  
PËRGATIT: Njësia e Bujqësisë  
MIRATON: Këshilli i Komunës
  
- ✓ **Informatë për realizimin e mbrojtjes shëndetësore primare të popullatës në Komunën e Dibrës**  
PËRGATIT: Shtëpia e shëndetit Dibër  
MIRATON: Këshilli i Komunës
  
- ✓ **Vendim për caktimin e emrave të rrugëve, shesheve, urave dhe objekteve tjera të infrastrukturës**  
PËRGATIT: Administrata komunale  
MIRATON: Këshilli i Komunës

- ✓ **Raport për kuartalin e tretë për realizimin e Buxhetit të Komunës për vitin 2016**  
PËRGATIT: Administrata komunale  
MIRATON: Këshilli i Komunës
- ✓ **Informatë nga fusha e punësimit në Komunë**  
PËRGATIT: Organi kompetent  
MIRATON: Këshilli i Komunës
- ✓ **Raport i Qendrës për informim të qytetarëve**  
PËRGATIT: Administrata komunale  
MIRATON: Këshilli i Komunës
- ✓ **Programi për pritje të organizuar të Vitit të Ri 2017**  
PËRGATIT: komisioni përkatës  
MIRATON: Këshilli i Komunës
- ✓ **Projektbuxheti i komunës për vitin 2017**  
PËRGATIT: administrate komunale në bashkëpunim me komisionin përkatës  
PROPOZON: Kryetari i Komunës  
MIRATON: Këshilli i Komunës
- ✓ **Buxheti i komunës për vitin 2017**  
PËRGATIT: administrate komunale në bashkëpunim me komisionin përkatës  
PROPOZON: Kryetari i Komunës  
MIRATON: Këshilli i Komunës
- ✓ **Vendim për realizimin e Buxhetit të komunës për vitin 2017**  
PËRGATIT: administrate komunale në bashkëpunim  
PROPOZON: Kryetari i Komunës  
MIRATON: Këshilli i Komunës
- ✓ **Raport për kuartalin e katërt për realizimin e Buxhetit të Komunës për vitin 2016**  
PËRGATIT: Administrata komunale  
MIRATON: Këshilli i Komunës
- ✓ **Pyetje këshilltarësh**
- ✓ **Program për punën e Këshillit për vitin 2017**  
PËRGATIT: Komisioni për përgatitjen e Programit të Këshillit  
PROPOZON: Komisioni  
MIRATON: Këshilli i Komunës

✓ **Raport për realizimin e programit për ndërtim, meremetin dhe mirëmbajtje të rrugëve dhe rrugicave lokale për vitin 2015 dhe Program për vitin 2017**

**PËRGATIT:** Administrata komunale

**MIRATON:** Këshilli i Komunës

**III.**Në vitin në vijim 2016, Këshilli i Komunës Dibër në suazat e kompetencave të veta do të ngrejë iniciativa para organeve shtetërore dhe organeve tjera për zgjidhjen e problemeve dhe çështjeve nga fusha të ndryshme të cilat janë nga interesi më i gjerë për qytetarët e Komunës.

Aktivitetet e dhëna nuk janë të përcaktuara me kohë, për shkak se të njëjtat do të jenë lëndë e diskutimeve në Këshill varësisht nga afatet ligjore, integriteti i problemeve dhe nevojës për rishqyrtim e tyre.

Varësisht nga kohëzgjatja e harmonizimit të ligjeve të veçanta dhe të Ligjit për vetadministrim lokal, Këshilli i Komunës e posedon të drejtën që të diskutojë edhe për çështje tjera sipas nevojës për zgjidhjen e tyre e që janë të rëndësishme për qytetarët e Komunës së Dibrës.

Programi për punë i Këshillit të Komunës Dibër për vitin 2016 ka karakter të hapur, ashtu që të gjitha problemet dhe çështjet që do të paraqiten gjatë vitit, për të cilat Këshilli, Kryetari dhe organet tjera do të vlerësojnë se janë me rëndësi të veçantë për jetën dhe interesin e qytetarëve, do të inkorporohen në Program.

**IV.**Për realizimin e Programit obligohen propozuesit, përpiluesit dhe të gjithë ata që duhet t'i përmbahen asaj.

**V.**Programi hyn në fuqi ditën e 8-të nga dita e shpalljes në „Kumtesën zyrtare të Komunës së Dibrës” ndërsa do të aplikohet nga data 01.01.2016.

**Nr.07-1219/10**  
**25.12.12.2015**  
**Dibër**

**KËSHILLI I KOMUNËS**  
**Kryetari,**  
**Bashkim Mashkulli d.v.**

**K O N K L U Z I O N**  
**Nr.08-1249/6 dt. 29.12.2015**  
**PËR SHPALLJEN E PËRFUNDIMIT PËR SJELLJEN E**  
**PROGRAMIT VJETOR PËR NDËRTIM, RINDËRTIM,**  
**REHABILITIM,MIRËMBAJTJE DHE MBROJTJE TË RRUGËVE**  
**KOMUNALE DHE RRUGICAVE NË KOMUNËN E DIBËR PËR .V. 2016**

**483.**Në mbështetje të nenit 50 të Ligjit për vetadministrimin lokal (“Gazeta zyrtare e RM” nr.5/02) si dhe nenit 45 të Statutit të Komunës Dibër (“Kumtesa zyrtare e Komunës”nr.14/03),

Kryetari i Komunës Dibër:

**K o n k l u d o i**

Shpallet përfundimi për sjelljen e Programit vjetor për ndërtim,rindërtim, rehabilitim , mirëmbajtje dhe mbrojtjen e rrugëve komunale dhe rrugicave në Komunën Dibër për vitin 2016 nga Këshilli i Komunës në seancën e 30<sup>të</sup> dt. 25.12.2015.

**KOMUNA DIBËR**  
**Kryetari,**  
**Ruzhdi Lata d.v.**

**P Ë R F U N D I M**  
**Nr. 07-1219/11 dt. 25.12.2015**  
**PËR SJELLJEN E PROGRAMIT VJETOR PËR**  
**NDËRTIM, RIKONSTRUIM, REHABILITIM, MIRËMBAJTJE DHE**  
**MBROJTJE TË RRUGËVE KOMUNALE DHE RRUGICAVE NË**  
**KOMUNËN E DIBRËS PËR .V. 2016**

**484.**Në mbështetje të nenit 59 të Statutit të Komunës Dibër (“Kumtesa zyrtare e Komunës”nr.14/03),

Këshilli i Komunës Dibër në seancën e 30<sup>të</sup> dt. 25.12.2015 përfundoi:

- 1.Këshilli i Komunës Dibër solli programin vjetor për ndërtim, rikonstruim, rehabilitim, mirëmbajtje dhe mbrojtje të rrugëve komunale dhe rrugicave në Komunën e Dibrës për vitin 2016.
2. Pjesë përbërëse e përfundimit është Programi nga pika 1.
3. Ky përfundim hyn në fuqi ditën e miratimit dhe do të shpallet në “Kumtesën zyrtare të Komunës”

**KËSHILLI I KOMUNËS**  
**Kryetari**  
**Bashkim Mashkulli d.v.**

**Nr.30/29.12.2015 KUMTESA ZYRTARE E KOMUNËS faq. 921**

**485.**Në mbështetje të nenit 14 paragrafi 4 të Ligjit për rrugët publike (“Gazeta zyrtare e RM” nr. 84/2008, 52/2009, 114/2009, 124/10, 23/11,53/11, 44/12, 168/12, 163/13, 187/13, 39/14 , 42/14, 166/14, 44/15,116/15 dhe 150/15), dhe nenit 27 paragrafi 1 pika 12 të Statutit të Komunës së Dibrës, (“Kumtesa zyrtare e Komunës”nr.14/03),

Këshilli i Komunës Dibër në seancën e 30<sup>të</sup> dt. 25.12.2015 solli:

**PROGRAM VJETOR  
PËR NDËRTIM, RIKONSTRUIM, REHABILITIM ,MIRËMBAJTJE DHE  
MBROJTJE TË RRUGËVE KOMUNALE DHE RRUGICAVE NË  
TERRITORIN E KOMUNËS DIBËR, PËR VITIN 2016**

<b>TE ARDHURAT</b>	
<b>Të ardhura:</b>	<b>Shuma:</b>
Ndërmarrja publike për rrugë shtetërore -Shkup	10.000.000,00
Participim (komuna me qytetaret)	50.000.000,00
Agjencioni për zhvillim të barabartë në R.M.	10.000.000,00
Donacione	30.000.000,00
<b>Gjithsejt të ardhura:</b>	<b>100.000.000,00</b>

<b>SHPENZIME</b>			
<b>I.</b>	<b>Ndërtimi i rrugëve komunale</b>	<b>M2</b>	<b>Shuma:</b>
1.	Ndërtimi i rrugës për fshatin Ame (rruga e vjetër për fsh. Banisht)	10500	16.000.000,00
2.	Ndërtimi së rrugës, lidhja: rruga Bllatë-Banisht	12500	15.000.000,00
3.	Ndërtimi i rrugës, Ame-Banisht	5000	8.000.000,00
4.	Ndërtimi i rrugës, brenda f. Banisht	2000	1.200.000,00
5.	Ndërtimi i pjesës së rrugës për fshatin Rajçicë	2000	1.200.000,00
6.	Ndërtimi i pjesës së rr. për fshatin Kosovrast i Poshtëm	3500	5.000.000,00
7.	Ndërtimi i pjesës së rrugës për fshatin Otishan	1500	900.000,00
8.	Ndërtimi i pjesës së rrugës për fshatin Zepisht	1500	900.000,00
9.	Ndërtimi i pjesës së rrugës për fshatin Shullan	500	300.000,00
10.	Ndërtimi i pjesës së rrugës për fshatin Osoj	1200	900.000,00
11	Ndërtimi i pjesës së rrugës për fshatin Tatar Elevcë	1000	600.000,00
<b>Gjithsejt:</b>			<b>50.000.000,00</b>

<b>II.</b>	<b>Ndërtimi i rrugëve komunale dhe rrugicave (në qytet):</b>	<b>M2</b>	<b>Shuma:</b>
1.	Rindërtimi i pjesës së rrugës “Bashkim Vëllazërim” prej te Shtëpia e pensionistëve deri te lidhje me rrugën “22 Dhjetori”	3500	5.000.000,00
2.	Rindërtimi i pjesës së rrugës ”Atanasie Iliq”	4000	5.000.000,00
3.	Rindërtimi i pjesës së rrugës ”Urfi Agolli”	2000	2.500.000,00
4.	Rindërtimi i pjesës së rrugës “Mosha Pijade”	2000	2.500.000,00
5.	Ndërtimi i pjesës së rr.”102” (me punë paraprake)	1000	1.000.000,00
6.	Ndërtimi i pjesës së rr. “Zija Mersovski” (Venec-I)	1900	2.000.000,00
7.	Ndërtimi e rrugës “rruga e lopeve” (Progresi)	8000	12.500.000,00
8.	Ndërtimi e rruges “H” -Venec-II,	600	2.000.000,00
9.	Ndërtimi e rruges “3” -Venec-II,	1500	2.000.000,00
10.	Rindërtim i pjesës së rrugës “Partizani”	1000	1.000.000,00
11.	Ndërtimi i rrugëve dytësore(anësore) në Dibër, (rrugët: Qendra për Kulturë, Salla sportive, Vidoe Smi.Bato dhe tj.)	Paushall	10.000.000,00
<b>Gjithsejt</b>			<b>45.500.000,00</b>

<b>III.</b>	<b>Mirëmbajtja dimërore e rrugëve (në qytet dhe fshatra):</b>	<b>Paushall</b>	<b>Shuma:</b>
1.	Mirëmbajtja dimërore në qytet dhe fshatra	Paushall	1.500.000,00
		<b>Gjithsejt:</b>	<b>1.500.000,00</b>

<b>IV.</b>	<b>Shpenzime tjera</b>	<b>Paushall</b>	<b>Shuma:</b>
1.	Mbushja e gropave nëpër rrugët komunale dhe rrugicat në qytet dhe fshatra	Paushall	2.000.000,00
2.	Sinjalizimi horizontal dhe vertikal	Paushall	500.000,00
3.	Përgatitja e projekteve dhe studimi për rrugët	Paushall	500.000,00
		<b>Gjithsejt:</b>	<b>3.000.000,00</b>

<b>REKAPITULIM I SHPENZIMEVE</b>		<b>Shuma:</b>
Ndërtimi i rrugëve komunale (në fshatra)		50.000.000,00
Ndërtimi i rrugëve komunale dhe rrugicave (në qytet)		45.500.000,00
Mirëmbajtja dimërore në qytet dhe fshatra		1.500.000,00
Shpenzime tjera		3.000.000,00
<b>GJITHSEJT SHPENZIME:</b>		<b>100.000.000,00</b>

<b>TË ARDHURAT</b>	<b>100.000.000,00</b>
<b>SHPENZIMET</b>	<b>100.000.000,00</b>
<b>TË ARDHURA - SHPENZIME</b>	<b>-</b>

**Nr.07-1424/12**  
**25.12.2015**  
**D i b ë r**

**KËSHILLI I KOMUNËS**  
**Kryetari,**  
**Bashkim Mashkulli d.v.**

**K O N K L U Z I O N**  
**Nr.08-1249/7 dt. 29.12.2015**  
**PËR SHPALLJEN E VENDIMIT PËR SJELLJE TË NDRYSHIMIT DHE**  
**PLOTËSIMIT TË PLANIT GJENEREAL URBANISTIK TË QYTETIT**  
**DIBËR PËR BLOQET 3, 4, 17 dhe 20 (2014-2024)**

**486.**Në mbështetje të nenit 50 të Ligjit për vetadministrimin lokal (“Gazeta zyrtare e RM” nr.5/02) si dhe nenit 45 të Statutit të Komunës Dibër (“Kumtesa zyrtare e Komunës”nr.14/03),

Kryetari i Komunës Dibër:

**K o n k l u d o i**

Shpallet vendimi për ndryshim dhe plotësim të PGJU të qytetit Dibër për Blloqet **3, 4, 17 dhe 20 (2014-2024)**, miratuar nga Këshilli i Komunës në seancën e 30<sup>të</sup> dt. 25.12.2015.

**KOMUNA DIBËR**  
**Kryetari,**  
**Ruzhdi Lata d.v.**



**V E N D I M**

**Nr.07-1219/13 dt. 25.12.2015**

**PËR SJELLJE TË NDRYSHIMIT DHE PLOTËSIMIT TË PLANIT  
GJENEREAL URBANISTIK TË QYTETIT DIBËR PËR BLOQET 3, 4,  
17 dhe 20 (2014-2024)**

**487.**Në mbështetje të nenit 25, paragrafi 5 të Ligjit për planifikim hapsinor dhe urbanistik (“Gazeta zyrtare RM-së” nr. 51/05, 137/07, 91/09,124/10, 18/11, 53/11,144/12, 55/13, 163/13 dhe 42/14), nenit 22, paragrafi 1, pika 1 dhe nenit 36 të Ligjit për vetëqeverisjen lokale, (Gazeta zyrtare e RM-së nr. 5/02) dhe nenit 27 paragrafi 1 pika 7 të Statutit të komunës Dibër, (“Kumtesa zyrtare e komunës Dibër” nr. 14/03),

Këshilli i Komunës Dibër në seancën e 30<sup>të</sup> dt. 25.12.2015 vendosi:

**Neni 1**

Sjelllet NDRYSHIMI DHE PLOTËSIMI I PLANIT GJENEREAL URBANISTIK TË QYTETIT DIBËR PËR BLOQET 3, 4, 17 DHE 20 (2014-2024). me përfshirje të përgjithshme prej 69.75 ha.

**Neni 2**

Plani nga neni 1 i këtij Vendimi me numër teknik 032/04/14 është i punuar nga Shoqëria për Planifikim, Projektim dhe Inxhinjerig “TAJFA-PLAN” SHPK Shkup dhe përmban pjesën tekstuale dhe grafike.

**Neni 3**

Plani verifikohet në afat prej 8 (tetë) ditësh nga dita e miratimit në 7 (shtatë) ekzemplarë dhe ju dërgohen shërbimeve dhe organeve shtetërore kompetente, në pajtim me Ligjin për planifikim hapsinor dhe urbanistik.

**Neni 4**

Planin do ta zbatojë organi kompetent i komunës Dibër.

**Neni 5**

Ky vendim me një ekzemplar të verifikuar të Planit i dorëzohet Organit të administratës shtetërore kompetente për punët nga sfera e rregullimit të hapsirës.

**Neni 6**

Ky vendim hyn në fuqi në ditën e 8-të nga dita e shpalljes në “Gazetën zyrtare të Komunës Dibër”.

**KËSHILLI I KOMUNËS**

**Kryetari,**

**Bashkim Mashkulli d.v**

**P Ë R M B A J T J A**

470	Konkluzion për shpallje të përfundimit për sjelljen e Buxhetit të Komunës Dibër për vitin 2016	868
471	Përfundim për sjelljen e Buxhetit të Komunës Dibër për vitin 2016	869
472	Buxheti i Komunës Dibër për vitin 2016	870
473	Konkluzion për shpallje të vendimit për realizimin e Buxhetit të Komunës Dibër për vitin 2016	895
474	Vendim për realizimin e Buxhetit të Komunës Dibër për vitin 2016	896
475	Konkluzion për shpallje të vendimit për caktimin e vlerës së pikës për përlllogaritjen e rrogës së nëpunësve shtetëror për vitin 2016 në Komunën Dibër	900
476	Vendim për caktimin e vlerës së pikës për përlllogaritjen e rrogës së nëpunësve shtetëror për vitin 2016 në Komunën Dibër	901
477	Konkluzion për shpallje të përfundimit për sjelljen e Programit për mirëmbajtjen e pastërtisë publike në territorin e Komunës Dibër për vitin 2016	902
478	Përfundim për sjelljen e Programit për mirëmbajtjen e pastërtisë publike në territorin e Komunës Dibër për vitin 2016	903
479	Program për mirëmbajtjen e pastërtisë publike në territorin e Komunës Dibër për vitin 2016	904
480	Konkluzion për shpallje të përfundimit për sjelljen e Programit për punën e Këshillit të Komunës për vitin 2016	911
481	Përfundim për sjelljen e Programit për punën e Këshillit të Komunës për vitin 2016	912
482	Program për punën e Këshillit të Komunës për vitin 2016	913
483	Konkluzion për shpallje të përfundimit për sjelljen e Programit vjetor për ndërtim, rindërtim, rehabilitim , mirëmbajtje dhe mbrojtjen e rrugëve komunale dhe rrugicave në Komunën Dibër për vitin 2016	919
484	Përfundim për sjelljen e Programit vjetor për ndërtim, rindërtim, rehabilitim , mirëmbajtje dhe mbrojtjen e rrugëve komunale dhe rrugicave në Komunën Dibër për vitin 2016	920
485	Program vjetor për ndërtim, rindërtim, rehabilitim , mirëmbajtje dhe mbrojtjen e rrugëve komunale dhe rrugicave në Komunën Dibër për vitin 2016	921
486	Konkluzion për shpallje të vendimit për ndryshim dhe plotësim të PGJU të qytetit Dibër për Blloqet <b>3, 4, 17 dhe 20 (2014-2024)</b>	923
487	Vendim për ndryshim dhe plotësim të PGJU të qytetit Dibër për Blloqet <b>3, 4, 17 dhe 20 (2014-2024)</b>	924